



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
p.n.
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Adresa: Dëshmorët e Kombit

DATA/DATUM/DATE	14.09.2020
11 NR/BR.	11/88
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim



Thirrje për aplikim

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë-Ferizaj në bazë të vendimit të datës 08.06.2020 në përkrahje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2020 do të bëjë: Furnizimin e fermerëve kultivues të grurit me pleh të kombinuar NPK 15:15:15.

Sasia e plehut prej 150,000kg do të shpërndahet në mënyrë proporcionale bazuar në sipërfaqen për të cilën kanë aplikuar.

Përfitues mund të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt,
- Parcelat e mbjellura të jenë në teritorin e komunës së Ferizajt,
- Fermerët që kishin të mbjellur 2 ha e më shumë grurë gjatë vitit 2020 dhe kanë aplikuar për subvencione të grurit nga MBPZHR;

Vërejtje: Në rast të deklarimit jo të saktë të sipërfaqes së mbjellur me grurë fermerët do të ndëshkohen për 3 vite me humbje të drejtës për aplikim për subvencione dhe grante nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë Ferizaj.

Fermerët e interesuar do të aplikojnë në Zyrën Pritëse- kati përdhese- Komuna e Ferizajt.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Fletëaplikacionin e plotësuar (mirret në Zyrën Pritëse);
- Kopjen e dëshmisë – Formularit që keni aplikuar për subvencione në MBPZHR;

Afati për aplikim fillon nga data 14.09.2020 deri më 25.09.2020.